

SHOQËRIA CIVILE ALARMON PËR GJENDJEN E RËNDË NË SFERËN E SHËNDETËSISË

YHR: Shëndetësia e Lipjanit në krizë shkaku i keqmenaxhimit

Arian Duriqi

LIPJAN, 5 MARS - Organizata jo-qeveritare Aksioni i të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YHR) ka shprehur shqetësimin mbi gjendjen e tmerrshme që po mbretëron në sektorin shëndetësor në Komunën e Lipjanit. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YHR, fajn mbi këtë gjendje nuk po e hedh mbi autoritetet aktuale të Lipjanit, por mbi ato paraprake dhe mbi nivelin qendror.

“Me gjithë angazhimet e shumta të Drejtorisë së re Komonale për Shëndetësi në Komunën e Lipjanit, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese në sektorin shëndetësor, prapë se prapë gjendja momentale është katastrofale në këtë sektor, me fajn e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të keqmenaxhimit të këtij sektori nga menaxhmenti i kaluar komunal me vite të tëra”, ka thënë Krasniqi. E ky ka shqetësime edhe për gjendjen në Shërbimin e Emergjencës. Aty mungojnë shiringat dhe gjithçka tjetër, ndër më elementaret.

“Në Shërbimin për emergjencë që gjendet në kuadër të QKMF-së pacienti duhet të marrë me vete të gjitha gjërat elementare duke filluar nga shiringat, gypin përçjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësor dhe plot gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent. Dhe kjo është e tmerrshme”, ka shtuar Krasniqi.

Ky ka bërë thirrje drejt autoriteteve komunale që ta rregullojnë gjendjen ekzistuese.

“Organizata jonë i bën thirrje ekzekutivit të Lipjanit që të angazhohet maksimalisht në ku-

jdesin shëndetësor për qytetarët e vet duke ndarë mjete buxhetore për plotësimin e këtyre mungesave të medikamenteve, e cila është si pasojë e një keqmenaxhimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe të bëjë një ristrukturim të personelit shëndetësor”, është shprehur Krasniqi.

Kurse kryetari i Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë për KD-në se janë ndërmarrë disa hapa që çojnë drejt një situatë më të mirë në QKMF. Ai ka deklaruar se qysh në fillimin e mandatit të tij ka vizituar QKMF-në dhe aty ka gjetur disa gjëra që nuk ishin në vendin e tyre. Për shembull, ka përmendur faktin se secili mjek ka pasur një TV në dhomën e tij.

“Hapat e parë që janë ndërmarrë në QKMF janë hapat e ngritjes së nivelit të disiplinës aty dhe një lloj ristrukturimi i ri që ka ndodhur në disa sektorë të caktuar. Hap tjetër që është ndërmarrë është edhe heqja e televizorëve nga dhomat e mjekëve,

sepse secili mjek e ka pasur nga një TV. Por, është hequr edhe participimi i qytetarëve prej 5 eurosh. Më nuk e kanë këtë participim”, ka thënë Ahmeti.

Po këto ditë është hapur edhe një konkurs për pranim të 3 mjekëve të rinj në QKMF, kurse kreu lipjanas po thotë se ky konkurs e ka një qëllim të mirë, rritjen e mjekëve dhe jo të stafit teknik, sikur që ka ndodhur më herët.

“Ne do të vazhdojmë me ristrukturim dhe marrjen e kuadrove për të rritur numrin e mjekëve në raport me stafin teknik, sepse më herët ka pasur rritje të stafit teknik dhe jo të mjekëve. Po pretendojmë ta bëjmë të kundërtën e asaj që është praktikuar më herët, përderisa furnizimi me barna esenciale është temë e nivelit qendror dhe jo e atij lokal”, ka mbyllur Ahmeti.

© KOHA Ditore



m

SH
“Nai
ta ap
ndëri
vjetë
nisur
sioni
Abi
thënë
deris
mësi
alish
mësi
“Do
do ta
me 3
një o
do të
Gjith
vazh
seps
novo
isht
përpi
ndëri
po e
ndos
ndëri
orën
tjetër
E,
novi
Dura
pakë